

VENDIM
Nr. 317, datë 12.12.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 174, DATË
29.8.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘FAETHON’ SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2539/4 prot., datë 26.11.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Faethon’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Faethon” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 29.8.2024, ka licencuar shoqërinë “Faethon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 78.6 mw AC, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikën 2, të vendimit nr. 174/2024, është përcaktuar se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, jo më vonë se data 14.2.2027.

- Në pikën 3, është përcaktuar se shoqëria “Faethon” sh.p.k. duhet të raportojë në ERE në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltai dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 4.10.2025.

- Në pikën 4 është përcaktuar se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i administruar

- ERE, me shkresën nr. 2539 prot., datë 29.9.2025, i është drejtuar shoqërisë “Faethon” sh.p.k., duke i kërkuar informacion për zbatimin e pikës 3, të vendimit nr. 174/2024, në veçanti lidhur me dokumentimin e fillimit të punimeve deri më 4.10.2025.

- Shoqëria “Faethon” sh.p.k., me shkresën nr. 11 prot., datë 3.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2539/1 prot., datë 6.10.2025, ka bërë me dije se ka aplikuar pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) për pajisjen me lejen e zhvillimit dhe në vijim me lejen e ndërtimit, por se deri në atë moment nuk kishte marrë një përgjigje zyrtare dhe për rrjedhojë, nuk kishte filluar ende punimet për ndërtimin e parkut fotovoltai.

- Në kushtet kur punimet nuk kishin filluar dhe VNM-ja paraprake kishte skaduar më datë 4.10.2025, ERE, me shkresën nr. 2539/2 prot., datë 11.11.2025, i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse disponon një VNM të vlefshme apo ka aplikuar për rinovimin e saj, si dhe të paraqesë informacion në lidhje me raportimet periodike (çdo 3 muaj) pranë MIE-s dhe AKBN-së, në zbatim të pikës 1, germa “gj”, të VKM-së nr. 67, datë 14.2.2024 dhe nenit 9, të kontratës nr. 2427 rep., nr. 1333 kol., datë 5.4.2024, të nënshkruar me MIE-n.

- Shoqëria “Faethon” sh.p.k., me shkresën nr. 13 prot., datë 14.11.2025, protokolluar në ERE me nr. 2539/3 prot., datë 18.11.2025, ka sqaruar se studio e projektimit e ngarkuar nga shoqëria është duke punuar për përgatitjen e aplikimit përkatës pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

(AKM) për rinovimin e VNM-së paraprake dhe se shoqëria do të informojë ERE-n pas depozitimit të aplikimit.

- Po në këtë shkresë, shoqëria ka bërë me dije se, me shkresën e saj nr. 12 prot., datë 13.10.2025, ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore lidhur me ecurinë e projektit, në përputhje me detyrimet e kontratës me MIE-n dhe VKM-në nr. 67/2024.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Pika 3, e vendimit nr. 174/2024, parashikon detyrimin për raportim periodik në ERE dhe dokumentimin e fillimit të punimeve jo më vonë se data 4.10.2025, afat i cili është lidhur me vlefshmërinë e deklaratës mjedisore (VNM paraprake).

- Duke qenë se VNM-ja paraprake ka skaduar më datë 4.10.2025, ndërkohë që punimet për ndërtimin e parkut fotovoltaik nuk kanë filluar ende, kushti aktual i pikës 3 nuk mund të përmbushet në formën ekzistuese dhe nuk reflekton më situatën ligjore të projektit.

- Në këtë fazë, detyrimi thelbësor për vijimin e projektit është rinovimi i VNM-së paraprake pranë AKM-së, në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor dhe aktet e miratimit të projektit (VKM-ja nr. 67/2024 dhe kontrata me MIE-n).

- Për rrjedhojë, vlerësohet e nevojshme që pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, të riformulohet, duke i vendosur shoqërisë “Faethon” sh.p.k. një afat të qartë dhe të matshëm për depozitimin në ERE të një kopjeje të aplikimit pranë AKM-së për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se:

- Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, duhet të ndryshohet, duke kaluar nga një detyrim për dokumentimin e fillimit të punimeve brenda një afati tashmë të tejkaluar, në një detyrim konkret për paraqitjen në ERE të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për rinovimin e VNM-së paraprake, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, ndryshohet si vijon: “Shoqëria “Faethon” sh.p.k., brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të depozitojë në ERE një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar.”.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Faethon” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti